



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**KOMISIONI PËR INTEGRIME EVROPIANE**

**Legjislatura e –III-  
Mbledhja nr. 6  
Prishtinë, më 14.4.2008, ora 12:35  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10**

**P R O C E S V E R B A L**

Në mbledhje morën pjesë: Zylfije Hundozi , Sabri Hamiti, Naser Rugova , Fatmir Rexhepi, Đezair Murati, Nait Hasani, Branislav Grbić, Hydajet Hyseni dhe Lutfi Haziri,

Munguan: Njomza Emini dhe Edita Tahiri

Në mbledhje morën pjesë nga Zyra ndërlidhëse të Komisionit Evropian  
Khalidoun Sinno dhe Federina Donanin.

Nga zyra e komisioneve të Kuvendit : Minire Hasani, Ahtere Loxha, Adelina Demolli  
dhe Manush Kransiqi

Pjesëmarrsit tjerë: Avni Zuka NDI, Petrit Zejnullahu, Ermal Krasniqi NDI, Blerim Vela  
OMIK, Agron Demi Instituti GAP, Filloreta Kabashi AIE/ZKM

**Mbledhjen e kryesoi Zylfije Hundozi kryetare e Komisionit me këtë ;**

**Rend Dite**

- 1. Miratimi i rendit të ditës.**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dt. 26. 03.2008,**
- 3. Prezantim lidhur me praninë dhe rolin e Komisionit Evropian në Kosovë,**

#### 4. Shqyrtimi i programit dhe prioriteteve legislative në Kuvend, 5. Të ndryshme

**Zylfije Hundozi** hapi mbledhjen duke iu uruar mirëseardhje përfaqësuesve të zyrës ndërlidhëse të Komisionit Evropian z. Khaldoun Sinno dhe znj. Federina Donanin, kërkoj nga anëtarët e komisionit që të kalohen dy pikat e para të rendit të ditës dhe të fillohet me pikën e tretë për t'ia dhënë fjalën z. Sinno që ta njoftoj komisionin lidhur me rolin e Zyrës ndërlidhëse të Komisionit Evropian, raportet me institucionet e Kosovës dhe kontributin e tyre për integrimin e Kosovës në Bashkësinë Evropiane.

1. Rendi i ditës u miratua me këtë ndryshim.

Në vazhdim kryetarja ia dha fjalën z. Sinno.

**Khaldoun Sinno** shprehi kënaqësinë e tij për pjesëmarrjen në mbledhje të komisionit në mënyrë që të njoftoj komisionin lidhur me rolin e BE-së në Kosovë, sepse tha se në publik ka huti lidhur me rolin e BE-së andaj do ta qartësoj.

Vlerëson se ky komision është shumë i rëndësishëm për Kuvendin, pasi Kosova ka bërë disa zgjedhje për integrim në BE dhe do të ketë rol kyç, se si ky proces do të shkojë me tutje. Në vazhdim paraqiti një pasqyrë të shkurtër për prezencën e BE në Kosovë dhe rolin e saj, Bashkimi Evropian në Kosovë ka tri shtylla; Komisionin Evropian, Përfaqësuesin Special të Bashkimit Evropian dhe Misionin e Eulexit më me shume se 2000 njerëz.

Komisioni Evropian do të vazhdojë të jetë këtu edhe kur Kosova do të jetë anëtare e BE-së. Nuk ka funksion ekzekutiv por kjo do të jetë vetëm në kornizë të pakos së Ahtisarit. Perspektiva e Komisionit do të jetë për një kohë të gjatë, për deri sa bëhet në tërësi implementimi i Pakos së Ahtisarit. Përpjekimi të përdorim të gjitha veglat e politikës, e kemi partneritetin evropian dhe do ta bëjmë monitorimin e progresit çdo vit. Jemi fokusuar në reformat brenda Kosovës për një kohë të gjatë dhe jemi të angazhuar me autoritetet Kosovare për të implementuar dhe koordinuar aktivitetet me programet e komunitetit evropian.

Komisioni Evropian ka kontribuar për Kosovën dhe do të ndihmojë edhe në vitet e ardhshme për tejkalimin e sfidave. Jemi përpjekur që Kosova të përfaqësohet dhe të përfitoj nga iniciativat regjionale sepse Kosova ka nevojë për zhvillim ekonomik. Jemi të përfshirë për të ju ndihmuar për përgatitjen e Konferencës së Donatorëve për të gjetur fonde. Kemi një politikë për tërë regjionin që është stabilizim asociativ dhe të gjitha vendet e rajonit kanë aspirata për anëtarësim. Komisioni po kërkon mundësi për negociatë për marrëveshjen për të qenë anëtare e BE-së, por kjo përfshin edhe relacionet ekonomike në mes Kosovës dhe BE-së. Ne kemi mesazhe të rëndësishme për promovimin e vlerave evropiane në Kosovë, të bëjmë reforma dhe anëtarësimin në BE. Zyra e Komisionit Evropian në Kosovë luan një rol kyç në implementimin e politikave të BE-së përmes dialogut të përhershëm politik dhe teknik me autoritetet Kosovare duke u ofruar këshilla dhe ndihma mbi politika të shëndosha në përpjekjet e tyre për reforma.

Jemi angazhuar që nga viti 2002 për një dialog politik me autoritetet më të larta dhe ne si komision do të shohim se çfarë progresi është bërë.. Kemi pas takime të ndryshme si në Qeveri dhe institucione tjera dhe kemi bërë reforma në administratë, sundimin e ligjit dhe për të drejtat e minoriteteve. Ne fushën e ekonomisë kemi pasur takime me ndërmarrjet tregtare, doganat ,prokurimin publik, AQF-ën etj. Këto takime janë bere rregullisht dhe kanë qenë transparente. Për Kosovën dhe regjionin po bëjmë rishikimin vjetor dhe kemi publikuar raportin e progresit ,një dokument që tregon çka është arritur në të kaluarën në Kosovë. Jemi duke mbledhur informata nga institucionet e Kosovës dhe nga organizatat ndërkombëtare dhe do ti publikojmë në raportin ku do të shihet se a ka pasur përparim Kosova. Që ky raport të jetë koret dhe të shërbej si dokument referencë, kemi bërë at që ti identifikojmë problemet për ndihmë Kosovës me qëllim të ofrimit të mbështetjes financiare, për të ndërtuar dhe përmirësuar institucionet Kosovare,për të ndihmuar zhvillimin socio-ekonomik dhe për të avancuar më tej integrimin rajonal të Kosovës .Në fund tha se mendon se procesi është menaxhuar shumë mirë dhe është i hapur të ju përgjigjet pyetjeve të anëtarëve të komisionit.

### **Kryetarja falënderoj z. Sino dhe pyeti anëtarët nëse kanë pyetje për të parashtruar.**

**Nait Hasani** falënderoj z. Sino për prezantimin e bërë , por konsideroj se më mirë do të ishte që para komisionit të paraqitet raporti i Komisionit Evropian sepse do të ishte një bazë e mirë për tu njohtë me rrjedhat e zhvillimit që i kanë bërë dhe do ti bëjnë në të ardhmen , sepse konsideroj se broshura e paraqitur është mjaftë e vjetër për rrethanat që gjendemi ne, si komision dhe si Kosovë sepse tani duhet përmirësuar disa gjëra ,në një pjesë të këtij raporti përmendet çështja e statusit , që kjo çështje është tejkalua dhe tani kemi të bëjmë me zhvillimin në aspektin politik ekonomik drejt integritit në BE.

**Sabri Hamiti** falënderoj z. Sinno për prezencën dhe për shpjegimet e tij. Ai tha se është mirë të jenë në duar të këtij komisioni vlerësimet për gjendjen e Kosovës në rrjedhën e asaj që ne e kemi quajt mekanizëm përcjellës për stabilizim asocim . Është mirë të na shpjegohet në detaje siç kemi bërë më herët para komisionit për të parë nivelin e arritjeve dhe të mos arritjeve të Kosovës , në hapat e saj natyrisht të deklarimit politik për integritime.

Kërkoj shpjegim të shkurt dhe esencial nga z. Sinna edhe rreth asaj se qysh do të funksionojnë 3 shtyllat e Bashkimit evropian, si do të ndërveprojnë njëra me tjetrën për ta bërë substanciale ndihmën që Kosova të shkoj kah integritet evropiane.Për të mos u krijua një konfuzion i pranisë i qëllimeve dhe i bashkëpunimit tha ,neve na duhen adresa të sakta ose më konkretisht të na tregoni se çka koordinon Komisioni evropian me Piter Fejtin dhe Kermabon.

**Klaudian Sinna** tha se lidhur me pyetjen e parë plotësisht pajtohem në atë se duhet të jeni te përfshirë në integritet dhe monitorimet çka bënë qeveria dhe administrata dhe te jeni të njoftuar se kur po mbahen takimet çka po diskutohet edhe ne do t'ju dërgojmë raportin për partneritetin evropian .

Lidhur me pikën e dytë ai tha se duhet ta keni parasysh se është një prezencë e re ndërkombëtare në Kosovë, sepse më parë keni pasur disa organizata dhe agjensione ndërkombëtare si Agjensionin për rindërtim dhe disa tjera që ka qenë e vështirë të dihet se kush çka po bën, kurse mendojnë se tani në jemi të çart për publikun për atë se kush çfarë bën, sepse të tri shtyllat edhe pse kanë funksione të ndryshme janë të lidhura për kah origjina në institucionet e BE-së dhe për synimet për ti mbështetur institucionet e Kosovës në të gjitha nivelet e tyre përfshirë edhe perspektiven e tyre .Ne kemi bashkëpunim të ngushtë dhe takohemi rregullisht me Kermabo dhe Piter Feith dhe para se te caktojmë takime me autoritete Kosovare ne bashkëpunojmë ngushtë me ICO ne nivel teknik sa i përket Rregulloreve dhe Ligjeve . ICO është e interesuar për atë se si të përpilohen ligjet dhe cilat janë komentet , jemi të interesuar si komision për këtë se fundi i procesit të privatizimit është shumë i rëndësishëm për Kosovën, ICO është e interesuar ta bëjë transparente procesin sepse është e obliguar ta beje këtë nga mandati i Ahtisarit. Kemi planifikua një asistencë për sundimin e ligjit, për policinë kufitare dhe kemi bashkëpunim jo vetëm me policinë dhe Ministrinë e punëve të brendshme por edhe me Misionin e EULEX-it. Kemi tri shtylla dhe mandate të ndryshme por i kemi qëllimet e përbashkëta për Kosovën.

Lutfi Haziri pyeti z. Sina se cili është roli i Komisionit për ICO.

**Khaldoun Sinno** tha se roli ynë është që ta mbrojmë agjensionin me fonde ,nuk kemi rol ligjor por vetëm përkrahje financiare

**Zylfije Hundozi** kërkoi nga z.Sina mundësin e një bashkëpunimi më të afërt të komisionit për Integritet Evropian me Komisionin Evropian, lidhur me përpilimin e raportit për proceset në Kosovë për vitin 2008 që do të filloj në qershor të këtij viti.

**Khaldoun Sinno** në përgjigjen e tij tha se ne kemi të dhëna nga akterët e ndryshëm dhe kemi biseduar me Qeverinë dhe ata do të na dërgojnë raportin deri në qershor , por nëse ju mendoni se doni të kontribuoni direkt duhet zyrtarisht të kontaktoni me Qeverinë dhe Agjensionin për integritet Evropian .

**Hydajet Hyseni** falënderoj z. Sina për prezantimin e bërë dhe pasi është komunikimi i parë tha se do të njoftohemi me një informacion të përgjithshëm, e më vonë më shumë do të thellohem veç e veç. Në Kosovë ka një konsensus të gjerë në funksion të angazhimit të përgjithshëm të një dinamike të përsheptuar të integritetit në BE dhe ndihma e Komisionit Evropian është ma se e nevojshme . Kosova është e motivuar të integrohet shpejt në BE dhe ti përmbush standardet evropiane , por konfuzion ka sepse nuk ka një tablo të çart si funksionon struktura Evropiane dhe cila është rruga e integritetit . Është krijuar konfuzion i pa nevojshëm rreth shprehjes së standardeve evropiane ,sepse shumë manipulohet me këto standarde dhe secili i përdor sipas mënyrës së vet . Andaj tha është i nevojshëm standardizimi i standardeve, të jepet çart se çka është standardi, a mundet në një pjesë të vendit të vendit të jetë një standard i përmbushur kurse në një vend tjetër të ndodh krejt e kundërta. Duke shfrytëzuar atë se jemi pak euforik, kërkohet prej Kosovës të përmbushet ajo që objektivisht është e pamundur, deri tani kemi pas motivim politik dhe tani duhet të racionalizohet kjo pak, sepse duhet të jemi më konkret dhe më të përgjegjshëm me raportet. Në vazhdim tha se

nuk dua të ndalem të konkretizoj atë që po them ,por them të nënkuptohet,nëse kërkohet prej shoqërisë kosovare që standardet të jenë në nivele më të larta se sa që janë ato në rajon në realizimin e një fushë të caktuar p.sh te barazia gjinore në Kosovë kërkohet ti kaloj të gjitha nivelet e vendeve fqinje, ose ajo që thuhet referencat e parimeve të UNESKOS,kurse kur i krahason ato, dalin që jenë pikërisht e kundërta e parimeve të UNESKOS.

Në vazhdim theksoi se kemi nevojë të ballafaqohemi me këtë sindromë dhe të sqarojmë se çka janë standardet Evropiane çka janë synimet dhe cilat janë kapacitetet tona për ti përmbush.

Pasi që tani do të ketë një ndryshim në praninë ndërkombëtare ,vlerësoj se duhet rishikuar përvojat e UNMIK-ut , si ato pozitive dhe ato jo pozitive dhe së bashku ta parandalojmë një inercionë të vazhdimin të asaj që është dëshmuar si strategji e gabuar.

**Khaldoun Sinno** lidhur me standardet, mendon se ekzistojnë aspekte të ndryshme,aspekti i parë është se Kosova e ka shpall pavarësinë e saj, pastaj e ka shpall Kushtetutën e vetë sipas pakos dhe parimeve të Ahtisarit dhe ju të gjithë keni votuar për këtë dhe keni deklaruar se e pranoni. Ju duhet te mundoheni ti plotësoni standardet dhe si anëtar të Kuvendit është me rëndësi puna e juaj prej 17 shkurtit. Kur flasim për vlerësimet tona në rajon ne kemi standarde në të cilat përqendrohemi më tepër p.sh standardet për të drejtat e njeriut duhet të plotësohen dhe të dini se ne mundohemi te pasqyrojmë ne mënyre sa me objektive raportet tona .

Një çështje që ju e potencuat se cilat janë standardet evropiane dhe si i zbatoni ato, nëse doni te jeni anëtar i BE-se duhet ta implementoni Acquis commaunautaire organin e përgjithshëm të legjislacionit, tani nuk ka të bëjë me dëshirën e juaj ,por sa kohe duhen për tu plotësua ato. Çështja e dyte është se ne nuk kemi ende trup të definuar të ligjit por nëse doni të përdorni 27 praktikatat tona, një shembull do të ju jap lidhur me menaxhimin e kufirit. Brenda BE ka mënyra të ndryshme si e bëjnë menaxhimin e kufirit disa e përdorin ushtrinë, disa policin kufitare, mirëpo që ne të vijmë me një politik të harmonizuar ne kemi ardhur me një koncept për menaxhimin e kufirit , njëra prej tyre është mos me u bë kontrollimi ushtarak por angazhimi i disa agjensioneve që mëren me menaxhimin e kufijve, siç është Agjensioni veterinar, Agjensioni doganor dhe policia kufitare. Kjo është ajo që po mundohemi ta arrijmë në mbar regjionin.

**Sabri Hamiti** pas diskutimit të z.Sinna tha se do të ndalem në dy pika.

1.Bashkësia Evropiane është bashkim i vlerave Evropiane dhe i pranon veçantit, tash janë 27 përvoja edhe Kosova që synon të hyj në BE do ti jap vlerat e veta dhe do të jap përvojën e vet , siç po shihet do të jetë përvojë e veçantë.

Kosova duhet të krijoj përvojën e vet që del nga interesat e saja politike, ekonomike,sociale , natyrisht duke ruajtur univerzalitetin e të drejtave të njeriut. Nuk duhet të kërkohet nga Kosova të jetë shembull universal për 27 vendet, sepse kjo është e pa mundur dhe nuk do të jap sukses.

2.Lidhur me pikën e dytë tha se ne kemi kaluar me procedurë të shpejtuar ligjet që dalin nga pakoja e Ahtisarit dhe Komisioni Evropian mbikëqyr shtyllën e ligjshmërisë, se a janë ato ligje në përputhje me Aqumunitere .

Pyeti z. Sina për vlerësimin e tij për ligjet që dalin nga pakoja e Ahtisarit, se a janë në përputhje me parimet e Acquis Communautaire, a e ekzagjerojnë ato, apo janë brenda asaj.

**Hydajet Hyseni** u ndërlidh pas diskutimit të z. Hamiti dhe pyeti se si duhet të jetë qasja jonë, nëse ligjet ose dispozitat e caktuara të dokumentit të Ahtisarit janë në kundërshtim me parimet e Acquis Communautaire, ose në dokumentet universale për të drejtat e njeriut, p.sh në ligjet e pakos së Ahtisarit nuk i mundësohet komunitetit shumicë që ti përdorë emërtimet në lokalitetet e tyre që i kanë përdorur më përpara, kurse komuniteti pakicë ka këtë të drejtë ti përdorë emërtimet e mëparshme, kështu rastesh kemi mjaftë, si p.sh mbrojtjen e një monumenti të një besimi, që askush nuk e konteston se mbrohen si monumente kulturore jo si monumente etnike, por a duhet mbrojtur edhe monumentet e besimeve tjera që janë antike, ilire romake etj, pra si do të jetë qasja e jonë në situata të tilla që janë të shumta sipas dokumentit të Ahtisarit.

**Khaldoun Sinno** lidhur me atë, se a janë gjitha ligjet e pakos së Ahtisarit në përputhje me Acquis Communautaire tha se nuk mund t'ju jap përgjigje; por e di që në për integrimin po bëjmë të jenë kompaktibile, por mendoj se disa duhet të ndryshohen në një të ardhme të afërt.

Te çështjet e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjen e minoriteteve nuk është vetëm pakoja e Ahtisarit që obligon mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve, por ka edhe të tjera dokumente të cilat ju jeni të obliguar ti përmbushni dhe kjo varet prej juve që të siguronit se kjo po ndodh në Kosovë.

**Sabri Hamiti** tha se më parë kishte folur për veçantit ligjore dhe për veçantit e traditave. Diku një traditë dhe një kulturë ka qar në një kodifikim të sjelljes tjetër nga një traditë tjetër. P.sh tha se në Holandë marihuana shitet me pakicë e nuk shkon në burg askush, ndërsa në Shtetin tjetër si në Francë shkon dhe të dyja janë shtete të BE.

Traditat e vendeve kodifikohen në bazë të rëndësive që kanë në jetën sociale, prandaj universaliteti si formulë është problem dhe Kosova po shihet që ka veçantit e veta, prandaj tha se në po ngutemi të bëjmë legjislacionin universalit, por është problemi që ai legjislacion duhet të implementohet njëherë, e tek atëherë të provohet, sepse kur mendojmë për implementimin atëherë ne shohim se cili ligj funksionon e cili jo. Ndërsa BE është ai që na vlerëson se a janë ligje të mira apo jo. Prandaj shtrova pyetjen se a mendoni se këto ligje që po i bëjmë në konsultim me ju që tash, a janë të mira.

**Klaudiann Sinno** tha se nuk di që ka ndonjë legjislacion evropian që lejon të konsumohet marihuana. Një gjë që është princip bazik për legjislacionin evropian është të vendosni një minimum të kriterëve për ligjet, sepse kur e kemi çështjen për tregun e brendshëm organi i legjislacionit është i sigurt në punë dhe ka definuar disa kriterë minimale, por kjo nuk na sjell në çështje të detajuar të legjislacionit evropian, por kur flitet për çështjet tjera në ligje ka deklarata shumë të përgjithshme. Andaj ne kemi

punuar ne grupe punuese të Eulexit dhe ICO për të siguruar që këto kritere të definohen dhe të kenë kuptim. Kurse sa i përket ligjeve deri me tani tha se jemi te kënaqur .

**Zylfije Hondozi** falënderoj z. Sinno për prezantimin e tij të qartë lidhur me rolin e institucioneve të BE, për përgjigjet e dhëna dhe për bashkëpunimin e ofruar me këtë komision .

Në vazhdim kryetarja kaloi në pikën e tejkaluar më parë

## **2.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dt. 26. 03.2008 dhe transkripti i dëgjimit publik të dt.7.04.2008**

Sa i përket transkriptit kryetarja tha se nuk ka nevojë të miratohet' kurse lidhur me procesverbalin hapi diskutimin nëse ka vërejtje.

**Hydajet Hyseni** nuk kishte vërejtje në procesverbal, por konsideroj se edhe transkriptet duhet të vihen në miratim sepse edhe ai është dokument zyrtar dhe pjesë e procesverbalit, sepse nëse konstatohet nga anëtarët se ka vërejtje, të plotësohet dhe të ndryshohet .

### **Procesverbali i dt. 26. 03.2008 u miratua .**

**Zylfije Hundozi** tha se në debatin e fundit që e kishim pat vendosë që në komision të nxjerrim rekomandimet lidhur me anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës, andaj lidhur me këtë propozoj të formohet grupi punues prej 3 anëtarësh .

Pas diskutimeve të anëtarëve të komisionit u nxor ky:

### **Përfundim**

**U formua grupi punues i cili do të angazhohet për nxjerrjen e rekomandimeve lidhur me anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës.**

**Grupi punues është i përbërë nga Naser Rrugova Hydajet Hyseni dhe një anëtar nga Agjensioni për Integritet Evropiane .**

### **3. Shqyrtimi i programit dhe prioriteteve legjislativ në Kuvend,**

**Zylfije Hundozi** lidhur me këtë pikë konsideroj se Komisioni për integritet evropiane nuk do duhej ti shqyrtoj të gjitha ligjet se a janë në përputhje me Acquis Communautaire, por ti përzgjedhim ato ligje të cilat janë të nevojshme me i shqyrtua në bashkëpunim me zyrën e Agjensionit për integritet evropiane, i cili do të na jep fletën e përputhshmërisë dhe do të na tregoj më gjerësisht se cilat dokumente i ka shqyrtuar për të ardhë deri te vendimi përfundimtar .Ajo tha se e kishte ftuar znj. Sebiha nga Agjensioni për integritet të jetë prezent në mbledhje , mirëpo ajo ishte në një udhëtim zyrtar dhe nuk kishte mundur të merë pjesë në mbledhje , andaj tha se do të ishte më mirë komisioni ta pres znj Sebiha dhe në ndërkohë iu tha anëtarëve ti shikojnë se cilat ligje duhet të shqyrtohen dhe në mbledhjen e ardhshme të diskutohen .

## **Të ndryshme**

**Z. Hundozi** njoftoj komisionin se me datën 22 të këtij muaji do të mbahet një takim në Gorenje ku do të prezantohet z. Neven Mimica dhe do të njoftoj lidhur me përvojat e Kroacisë për rrugën në Integrimet Evropiane.

Në vazhdim ia dha fjalën Avni Zukes nga NDI.

Ai informoj komisionin se realizimi i vizitës në Shqipëri nuk mund të bëhet deri në Maj, për shkak të ndryshimeve politike që kanë ndodhur atje.

Mirëpo gjatë kësaj kohe tha se NDI mund ta organizoj një konferencë ku bashkërisht kishim ndihmua me e qartësua rrugën e integritit Evropian. Datë e mundshme është 29 prilli ku do të kishim mundur ti ftojme të gjithë faktorët relevant si dhe z. Stevan Pacaqek nga Çekia i cili mund të kontribuoj për bartjen e përvojave të Çekisë në integrimet Evropiane . Propozoj që tema të jetë „Kosova në procesin e integritimeve dhe roli i Kuvendit të Kosovës në këtë proces”.

.Në fund tha jemi të hapur dhe presim propozimet e juaja se kush do të ftohet në konferencë.

**Zylfije Hundozi** pajtohet me propozimin që e dha përfaqësuesi i NDI sepse e konsideron si të dobishme këtë konferencë për komisionin ,por pyeti anëtarët e komisionit se a pajtohen dhe lidhur me këtë hapi diskutimin.

**Nait Hasani** vlerësoj se do të ishte mirë më parë duhet ta kenë agjendën se kush do të merë pjesë, e pastaj të vendoset për mbajtjen e konferencës.

**Naser Rrugova** e konsideron konferencën si të dobishme për komisionin dhe bashkëpunimin e komisionit me NDI, për arsye se tha se e kam bindjen se ende jemi në një konfuzion të asaj se çka kërkojmë si Parlament dhe si Komision për integritime evropiane dhe formave të bashkëpunimit, por pse jo edhe të partneritetit. Pas 17 shkurtit ne duhet ti vemë binarët institucional të komunikimit dhe të partneritetit me të gjithë mekanizmat relevant. Në këtë konferencë duhet të hartohet një agjendë por jo nga NDI,por me kryetaren e komisionit dhe në bashkëpunim me të gjithë anëtarët e komisionit dhe ti ftojme të gjithë faktorët e përfaqësuesit relevant, të ftohen njerëzit që kanë qasje si edhe përfaqësuesit e vendeve siç është Çekia që në mënyrë brilante e ka kaluar tranzicionin sepse kur është i tërë Komisioni për integritime evropiane konsideroj se jemi mekanizëm shumë serioz që do ti perceptojmë dhe do ti orientojmë konkluzat e asaj konference në një seancë të Kuvendit dhe mund të ja dorëzojmë zyrtarisht edhe ekzekutivit të vendit.

**Hydajet Hyseni** e përkrah në parim mbajtjen e konferencës sepse e konsideron si të dobishme dhe një nismë e tillë tha se është praktikuar edhe në fushat tjera , pasi nuk është punë e ngutshme tha le të na dorëzohet njëherë si projekt e pastaj të shikojmë si ta pasurojmë. Mendon se do të ishte mirë të marim përvoja nga vendet që kanë kaluar

suksesshëm tranzicionin ,por të merën përvojat edhe nga vendet që janë të përafërta me kushtet tona dhe kombinimi i këtyre do të ishte zgjidhja më e mirë.

**Pas diskutimeve të anëtarëve të komisionit Kryetarja e Komisionit nxori këtë:**

**Përfundim**

**Nga përfaqësuesit e NDI të hartohet një agjendë e përafërt lidhur me mbajtjen e konferencës, se kush do të merë pjesë, cili është projekti ,cilat janë propozimet dhe pastaj nga Komisioni të plotësohet dhe të shikohet mundësia e realizimit .**

Komisioni përfundoi punimet në orën 14,00 min.

Procesverbalin e hartoj

Ahtere Loxha

Kryetarja e Komisionit

Zylfije Hundozi

